



**Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina**

Drejtoria e Bujqësisë

**PËRKRAHJA E FERMERËVE NË LËMIN E PRODHIMTARISË
ORGANIKE - BIMË AROMATIKE “KOPËR”**

Qëllimi:

Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në kuadër të planit zhvillimor në lëmin e bujqësisë, një rëndësi të veçantë i ka kushtuar përkrahjes së prodhimit organik - bimë mjekuese dhe aromatike.

Mbjellja sipërfaqeve bujqësore me këtë kulturë “Kopër”, është një ndër prioritetet, pasi që si bimë aromatike karakterizohet me veti nutrice dhe me një leverdi ekonomike.

Kriteret :

- Përkrahen fermerët për mbjellje të sipërfaqes prej 0,50-1,00 ha;
- Përfituesi/ja duhet të jetë banorë, si edhe të ketë pronën në territorin e komunës së Prishtinës;
- Fermerët janë të obliguar që ta bëjnë vet furnizimin me farë, si edhe mbjelljen e tyre në sipërfaqen e planifikuar;
- Sipërfaqet e planifikuara për mbjellje së paku tri vite nuk duhet të kenë qenë të mbjella me kultura konvencionale;
- Rimbursimi i mjeteve nga ana e Komunës për fermerët do të bëhet pas konstatimit se janë përmbushur të gjitha kriteret e kërkuara, dhe varësisht nga sipërfaqja e mbjellur;
- Fermerët duhet të furnizohen me farë nga entiteti i licencuar për prodhimin dhe tregtimin e bimëve aromatike-mjekuese “Kopër”.
- Fermerët që mbjellin sipërfaqe më të madhe kanë përparësi në përzgjedhje;
- Fermerët e përzgjedhur janë të obliguar që të bëjnë analizën e tokës - parcelës që do ta mbjellin me “Kopër” dhe nëse këto analiza tregojnë se ajo parcelë nuk i plotëson kriteret për kultivimin e kësaj kulture, atëherë përfituesi/ja do të refuzohet;
- Fermerët do të përkrahen prej 4 - 8 kg farë, varësisht nga madhësia e sipërfaqes së planifikuar për mbjellje;

- Vlera e përkrahjes do të jetë varësisht nga sipërfaqja e mbjellë;
- Çmimi i pranueshëm është 107,5 € / kg farë;
- Të gjitha transaksionet - pagesat duhet të realizohen nëpërmes sistemit bankar.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Kopja e një dokumenti identifikues valid i Republikës së Kosovës;
- Konfirmimin nga banka për xhirollogarin bankare;
- Certifikata mbi pronësinë e paluejtshme, me afat deri në një vit;
- Licenca e entitetit ku është bërë furnizimi me farë;
- Fatura;
- Certifikata e origjinës së farës;
- Certifikata fito-sanitare;
- Konfirmimi i transaksionit bankar.

Data e aplikimit, prej 30.03. deri 12.04.2017.